



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË LEPOSAVIQIT PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Leposaviqit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Leposaviqit (Leposaviq), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Leposaviqit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Përkundër rekomandimit nga viti i kaluar, komuna nuk i ka të regjistruara pasuritë mbi 1,000€ në SIMKF si dhe nuk e ka vënë në funksion sistemin e-pasuria. Vlera e prezantuar e pasurive mbi 1,000€ në PVF-të e komunës ishte zero, ndërsa vlera e regjistrimit të shpalosur në excel ishte 4,393,588€, e cila nuk përfshinë tërë pasurinë dhe kishte aplikuar zhvlerësimin e tyre. Po ashtu, katër pagesa në vlerë 811,772€ nuk ishin të regjistruara në regjistrin e Excel-it fare.

Ngjashëm edhe për pasuritë nën 1,000€, vlera e prezentuar në PFV ishte zero ndërsa e shpalosur në regjistër të excel-it ishte në vlerën 224,644€, edhe për këto nuk ishte aplikuar zhvlerësimi.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Leposaviqit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Gjatë angazhimit tonë kemi gjetur se entiteti nuk ka vepruar në pajtueshmëri me autoritetet si:

B2 Nuk zbaton ligjin nr.06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme përcakton qartë se secila organizatë buxhetore duhet të mbledhë të hyra nga tatimi në pronën e paluajtshme;

Nuk zbaton ligjin Nr. 04/L-110 për ndërtimet në nenet 16 dhe 27 ka përcaktuar qëllimin e lëshimit të lejeve ndërtimore;

Nuk zbaton ligjin Ligji nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës; dhe

Nuk ka nxjerr rregullore të brendshme për taksat, tarifatat dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e përfituara publike.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Leposaviqit .

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Leposaviqit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Leposaviqit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Leposaviqit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Leposaviqit .
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë të bëjnë me mangësitë në menaxhimin e pasurive kapitale dhe jokapitale, moszbatimin e ligjeve për mbledhjen e të hyrave, nxjerrja e urdhërblejeve me vonesë si dhe mos themelimi i njësisë së auditimit të brendshëm.

Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me katër rekomandime, prej tyre një rekomandim të ri dhe tri të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mangësi në menaxhim të pasurive kapitale dhe jo-kapitale

Gjetja Sipas nenit 6 të Rregullores MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore, çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që ka në menaxhimin e saj. Ky regjistër duhet të përfshijë pasuritë kapitale mbi 1,000€ që duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuritë jo kapitale nën 1,000€ dhe stoqet në E-pasuri.

Përkundër rekomandimeve nga vitet e kaluar, komuna ende nuk ka krijuar regjistra të saktë të pasurive mbi 1,000€ si dhe nuk e ka vënë në funksion sistemin e-pasuria. Komuna mban dy regjistra në Excel ku ka regjistruar pasuritë mbi dhe nën 1,000€. Mangësitë e identifikuara janë si në vijim:

- Komuna nuk ka të regjistruara në SIMFK pasuritë andaj është e pamundur të verifikohen vlerat e prezantuara nga komuna. Komuna mban pasuritë mbi 1,000€ në një regjistër në Excel në vlerën 4,393,588€ ndërsa në PFV ka prezantuar vlerën zero, mirëpo ka shpalosur 4,393,588€. Nëse i mbledhim vetëm shpenzimet kapitale për 4 vitet e fundit, vlera e pasurive të regjistruara do duhej ishte 7,319,972€ pa përfshirë donacionet e mundshme. Për më tepër nuk ka të regjistruar tokën që është në pronë të komunës.
- Po ashtu, katër pagesa në vlerë 811,772€, pasuri mbi 1,000€ nuk ishin të regjistruara në regjistrin në Excel (pagesa 51,541.55€; 388,078.50€; 285,310€; dhe 86,841.50€); dhe
- Komuna nuk e ka në funksion sistemin e-pasuria, ndërsa regjistrimin e pasurive nën 1,000 € e mban në excel. Vlera e prezentuar në PFV ishte zero ndërsa e shpalosur ishte në vlerën 224,644€, vlerë kjo e cila nuk ka zbritur shpenzimet e zhvlerësimi për vitin 2021.

Kjo tregon që vlerat e shpalosur në PFV nuk janë të sakta dhe të plota, kjo për arsye se zyrtari i certifikuar i komunës së Leposaviqit në fund të vitit 2021 nuk kishte qasje në sistem për të qenë në gjendje të regjistrojë pronën.

Ndikimi Dobësitë e identifikuara në menaxhimin e pasurisë që kanë të bëjnë me mos krijimin e regjistrit të pasurive, ndikojnë në raportimin e informatave jo të sakta për pasurinë e komunës dhe vlerën e tyre në PFV të cilat kanë ndikuar në opinion të auditimit. Njëherit, rrit rrezikun e keqpërdorimit dhe keq menaxhimit të tyre.

Rekomandimi B1 Kryetari, duhet të ndërmer masa për krijimin e regjistrave të pasurive mbi dhe nën 1,000€ duke regjistruar të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B2 - Moszbatimi i ligjeve për mbledhjen e të hyrave (tatimi në pronë, leje ndërtimit, dhe dhënies në shfrytëzim të pronës publike)

Gjetja Neni 25 i Ligji nr.06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme përcakton qartë se secila organizatë buxhetore duhet të mbledhë të hyra nga tatimi në pronën e paluajtshme. Gjithashtu edhe ligji nr. 04/L-110 për ndërtimet në nenet 16 dhe 27 ka përcaktuar qëllimin e lëshimit të lejeve ndërtimore. Ndërsa Ligji nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës rregullon mënyrën dhe përcakton procedurat dhe format për dhënien në shfrytëzim të pronës.

Gjatë vitit 2021, Komuna nuk kishte mbledhur të hyra nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, dhe pronat e dhëna në shfrytëzim si dhe nuk ka nxjerr rregullore të brendshme për taksat, tarifat dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e përfituara publike. Prandaj edhe niveli i mbledhjes së të hyrave vetjake është shumë i ultë.

Kjo ka ndodhur për shkak se Komuna ende nuk ka vendosur politika të zbatimit të ligjeve dhe nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për arkëtimin e të hyrave nga këto veprimtari që kanë ndikim të rëndësishëm në nivelin e buxhetit të komunës dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Gjithashtu, bazuar në PFV kjo po ndikon për shkak të komplikimeve që kanë të bëjnë me librat kadastralë.

Ndikimi Mos zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve për mbledhjen e tatimeve në pronë, taksave për leje të ndërtimit dhe të taksave e tarifave tjera nga ana e komunës, pasqyron një qasje joserioze për të aplikuar kërkesat ligjore në këtë fushë. Kjo rritë rrezikun e pa pajtueshmërisë me ligjet e aplikueshme dhe redukton nivelin e të hyrave vetjake, si dhe mundësinë e financimit të projekteve nga ky burim i të hyrave.

Rekomandimi B2 Kryetari, duhet të ndërmerr masa për krijimin e regjistrave të pasurive mbi dhe nën 1,000€ duke regjistruar të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2021 ishte 426,758€, prej tyre ishin shpenzuar 393,047€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndërtimi të rrugëve, kanalizime, objekte kulturore, pajisje tjera etj. Kemi testuar 9 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në vlerë 126,538€.

Çështja A1 - Nxjerrja e urdhërblërjeve me vonesë

Gjetja Rregulla financiare Nr.01/2013, neni 22, përcakton hapat për procedim të pagesave, ku fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje (zotimi i mjeteve), të procedohet urdhërblerja, pastaj pranimi i mallit, pastaj pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.

Gjatë testimit në 3 pagesa në vlerë 113,987€ të kategoria e mallrave dhe shërbime kemi vërejtur që urdhërblerjet ishin lëshuar pas pranimit të faturave.

Kjo ka ndodh si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efektive në procesin e menaxhimit dhe ekzekutimit të pagesave.

Ndikimi Procedimi i urdhërblërjeve me vonesë vështirëson zbatimin e drejtë të kontratave dhe krijon paqartësi rreth urdhërblërjeve për furnizim, shërbime apo fillim të punëve.

Rekomandimi A1 Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që procesi i ekzekutimit të pagesave të bëhet në harmoni me rregullat financiare për shpenzimin e parave publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ne kemi identifikuar edhe më tutje që Komuna nuk e kishte themeluar NjAB.

Çështja B3 - Mos themelimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm

Gjetja

Ligji Nr. 06 /L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike dhe rregullorja QKR Nr 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, kanë përcaktuar funksionin dhe mënyrën e themelimit të NjAB.

Përkundër rekomandimeve tona të përsëritura, komuna ende nuk ka arritur që të siguroj shërbimet e auditimit të brendshëm dhe nuk janë mbuluar as nga ndonjë organizatë tjetër.

Sipas menaxhmentit të komunës, kjo ka ndodhur si rezultat i pamundësisë për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën auditorit të brendshëm për shkak të mos aprovimit të pozitës nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Ndikimi

Mungesa e aktiviteteve të auditimit të brendshëm mund të ndikojë në vazhdimin e përsëritjes së dobësive në sistemet kyçe të kontrollit të brendshëm. Për më tepër, menaxhmenti mund të mos jetë në gjendje që t'i identifikojë dobësitë e kontrolleve dhe të reagojë me kohë për eliminimin e tyre.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të siguroj aprovimin e pozitave dhe të ndërmerr masa lidhur me themelimin dhe funksionimin e NjAB-së, për të siguruar mbështetje në menaxhimin e fushave me rrezik dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	4,313,184	4,640,634	4,053,949	4,947,369	4,290,990
Grante Qeveritare - Buxheti	4,271,394	4,322,547	3,980,880	4,823,614	4,254,335
Financimi përmes huamarrjes	0	13,651	13,651	1,890	0
Fondi zhvillimor në mirëbesim	0	117,098	0	0	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	50,954	10,450	84,755	12,655
Të hyrat vetanake	41,790	41,790	34,300	29,425	24,000
Donacionet e jashtme	0	94,593	14,668	7,685	0

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 327,450€. Kjo rritje është rezultat i rishikimi buxhetor për 51,153€, i bartjes së mjeteve nga Fondi zhvillimor në mirëbesim për 117,098€, të hyrave të bartura nga viti i kaluar 50,954€, financimit nga huamarrja 13,651€, si dhe donacioneve për 94,593€.

Në vitin 2021 Komuna ka shpenzuar 87% të buxhetit përfundimtar ose 4,053,949€, me një rënie 8% në krahasim me vitin 2020. Se si ishte realizuar buxheti sipas kategorive janë dhënë shpjegimet në tabelën në vijim.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	4,313,184	4,640,634	4,053,949	4,947,369	4,290,990
Pagat dhe mëditjet	2,206,175	2,276,453	2,270,980	2,210,804	2,010,506
Mallrat dhe shërbimet	425,770	426,758	393,047	554,385	382,402
Komunalitë	64,000	64,000	63,996	64,000	63,969
Subvencionet dhe transferet	70,000	80,575	72,950	328,113	70,000
Investimet Kapitale	530,342	1,792,847	1,252,977	1,790,067	1,764,113
Rezervat	1,016,897	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Në raport me buxhetin fillestar, kategoria e Pagave dhe Mëditjeve ishte rritur për vlerën 70,278€. Kjo rritje ishte prej grantit qeveritar për vlerën 51,153€, nga huamarrja 13,651€ dhe donacionet 5,474. Shpenzimet ishin 100€;
- Në raport me buxhetin fillestar, kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për vlerën 988€. Kjo rritje ishte nga te hyrat vetanake 15€ dhe donacioneve 973€. Shpenzimet ishin 92€;
- Buxheti i Shërbimeve komunale nuk kishte ndryshime buxhetore. Buxheti ishte shpenzuar 100%;
- Buxheti final i subvencioneve ishte rritur në raport me atë fillestar për vlerën 10,575€. Kjo rritje ishte prej të hyrave të bartura nga viti i kaluar. Shpenzimet ishin 91%; dhe
- Buxheti final te kategoria e investimeve kapitale në raport me atë fillestar ishte rritur për vlerën 1,262,505€. Kjo rritje ishte nga rezervat për 1,016,897€, nga fondi zhvillimor në mirëbesim 117,098€, të hyrave vetanake nga vitit i kaluar 40,364€ dhe donacioneve 88,146€. Shpenzimi në këtë kategori ishte 70%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2021 ishin në vlerë 2,247€, ato kanë të bëjnë me taksat administrative dhe nga taksat për certifikata të gjendjes civile.

Sa i përket planifikimit në arkëtimin e të hyrave, komuna ka planifikuar të arkëtoj 41,790€, ndërsa ka arkëtuar vetëm 2,247€ nga taksat administrative. Siç shihet realizimi i planit të të hyrave është shumë i ulët apo 5% me një përqindje të ngjashme me vitin e kaluar.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	41,790	41,790	2,247	1,664	1,646
Të hyrat jo tatimore	41,790	41,790	2,247	1,664	1,646

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të Komunës së Leposaviqit ka rezultuar në pesë rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, dy rekomandime ishin zbatuar ndërsa tri rekomandime nuk ishin zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjeve për mbledhjen e të hyrave, që kanë për qëllim në radhë të parë zbatimin e kërkesave ligjore si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Njëherit duhet të inicioj pa vonesë hartimin e një rregullore të brendshme për taksat, tarifatat dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e përfituara publike.	Edhe në këtë vit nuk ka ndërmarr masa Komuna për të hyrat si dhe nuk kishte hartuar rregulloren.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitetë	Kryetari i duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestini i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate	Nuk kemi vërejtur raste të tilla.	I zbatuar
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitetë	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat e pranuar mbajnë numrin e evidentuar në librin e protokollit.	Nuk kemi vërejtur raste të tilla	I zbatuar
4.	Pasuritë	Kryetari, duhet të ndërmerr masa për krijimin e regjistrave të pasurive mbidhe nën 1,000€ duke regjistruar të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë.	Edhe këtë vit kemi çështje të ngjashme	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të siguroj aprovimin e pozitave dhe të ndërmerr masa lidhur me themelimin dhe funksionimin e NjAB-së, për të siguruar mbështetje në menaxhimin e fushave me rrezik dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit.	Ende nuk është themeluar NJAB.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Etika Co shpk, (Fatmir Mehmeti person i autorizuar në emër të kompanisë)



Shtojca I: Letër konfirmimi

OPŠTINA LEPOSAVIĆ

POTVRDNO PISMO

O saglasnosti sa nalazima Generalnog Revizora na Izveštaj revizije za 2021. godinu kao i za sprovođenje preporuka

Za: Nacionalnu Kancelariju Revizije:

Poštovani,

Preko ovog psima, potvrđujem da:

- sam primio nacrt izveštaja Nacionalne Kancelarije Revizije o Reviziji Finansijskih Izveštaja Opštine Leposavić za godinu završno sa 31. decembrom 2021. (u daljem tekstu "Izveštaj");
- slažem se sa nalazima i preporukama i nemam komentare u vezi sa sadržajem izveštaja; i da ću
- u roku od 30 dana od prijema Završnog izveštaja, dostaviti Akcioni plan za sprovođenje preporuka, koji će uključiti vremenske rokove i osoblje koje je odgovorno za njihovo sprovođenje.

g. ZORAN TODIĆ

Gradočelnik Opštine Leposavić,

Datum: 24.05.2022. godine,

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.